

VENDIM
I ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË

Sot, më datë 09.06.2022, në orën 10.30, selinë e Shoqërisë GO GREEN sh.p.k, regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi L81911036L (më tej referuar si "SHOQËRIA"), me seli të regjistruar në adresën: Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati 89, Shkalla 1, Ap. 33, Tirane, u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me praninë e ortakut të vetëm **Z. Klenti Budina**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 09.01.1976, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 033663699 (këtu e në vijim "Ortaku i Vetëm").

Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë është mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dyte të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

REND DITE

- I. Përdorimi i shumës së huasë prej 150,000 Lekë (njëqind e pesëdhjetë mijë), që i është dhënë Shoqërisë nga Ortaku i Vetëm si kontribut për shlyerjen e vlerës së kuotës së kapitalit themeltar në të njëjtën shumë.*
- II. Të ndryshme*

Në përputhje me parashikimet e Statutit, Shoqëria ka një kapital themeltar në shumën 150,000 Lekë, i cili përbëhet nga një kuotë e vetme me të njëjtën vlerë nominale. Kjo kuotë është nënshkuar plotësisht nga Ortaku i vetëm por nuk është shlyer nga ana e tij. Ortaku i Vetëm i ka dhënë Shoqërisë disa hua në vlerën totale 978,658.00 Lekë. Asambleja pasi e shqyrtoi dhe vlerësoi me kujdes pikat e rendit të ditës si më lart,

VENDOSI që nga vlera totale e huave që i është dhënë Shoqërisë nga Ortaku i Vetëm, në shumën prej 978,658.00 Lekë, shuma prej 150,000 Lekë (njëqind e pesëdhjetë mijë), të përdoret si kontribut për shlyerjen e plotë të vlerës nominale së kuotës së kapitalit themeltar në të njëjtën shumë. Ky veprim do të ulë vlerën e detyrimit të Shoqërisë ndaj Ortakut të Vetëm.

Meqenëse nuk ka çështje të tjera për diskutim, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme deklarohet e mbyllur në orën 11:00.

ORTAKU I VETËM
Z. Klenti Budina



